



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 17.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **15.08.2023**, të parashtruar nga operatori ekonomik **PRO MEDICAL SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Servisimi i karrigeve stamatologjike në Njësitë Shëndetësore të Burgjeve”** me numër prokurimi **206-23-5709-2-2-1**, sot me dt. 17.08.2023 nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. e dt. 15.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i karrigeve stamatologjike në Njësitë Shëndetësore të Burgjeve” me numër prokurimi 206-23-5709-2-2-1, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK*, të datës 11.08.2023 të publikuar në platformën elektronike;
2. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i publikuar me datë: 11.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, kthen në rivleresim aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. me datë 15.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi i karrigeve stamatologjike në Njësitë Shëndetësore të Burgjeve” me numër prokurimi 206-23-5709-2-2-1. Autoriteti Kontraktues menjehere është marrë me shqyrtimin e kërkesës në fjalë dhe në bazë të dokumentacionit të lëndës, sot me datën 17.08.2023, vendosi si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkëlur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 1 – Qellimi

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi

Neni 72 – Sqarimet shtese

Neni 59 – Vleresimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 62 – Perfundimi i aktivitetit te prokurimit

Pretendimi ankimor

AK- Ministria e Shendetesise ne aktivitetin e prokurimit “Servisimi i karrigeve stamatologjike në Njësitë Shëndetësore te Burgjeve”

AK ne aktivitetin e prokurimit te larteshenuar ka bere hapjen e ofertave dhe me date 30.06.2023, kurse me date 11.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka bere Njoftimin mbi Vendimin e AK-se, ku AK e anulon aktivitetin e prokurimit, me arsyetimin se nuk ka asnje OE te pergjegjshem.

Ne kete aktivitet kane qene ofertues dy OE dhe AK-MSH nga dy OE vlereson se asnjeri nga ne nuk i ploteson kriteret e FDT-se dhe NJK-se.

Ju si AK Ministria e Shendetesise keni bere shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se, pasi qe keni bere anulimin e aktivitetit te prokurimit me arsyetimin se nuk keni asnje OE te pergjegjshem.

Lidhur me arsyetimin tuaj se ne si OE jemi i papergjegjshem, nuk qendron arsyetimi juaj si AK per arsye se ne kemi ofertuar dhe i kemi plotesuar kriteret e FDT-se, por gjate fazes se vleresimit ka skaduar afati i ISO standardit dhe ne si OE kemi qene te vetedijshem, dhe brenda periudhes per shkak se kompania ka qene e ngarkuar me pune te tjera nuk ka mund te bej vazhdimin e validitetit dhe kane kerkuar qe te presim deri sa LMS të bënë akreditimin, por ne si OE kemi vazhduar certifikimin me ISO 9001:2015 pra të bejme nga nje trup tjetër certifikuese dhe e kemi vazhduar afatin e Certifikates ISO 9001:2015 dhe ashtu kemi vepruar dhe e kemi nxjerr Certifikaten ISO daten e skadimit.

Pra, ne si OE kemi ofertuar me certifikate valide, mirepo per shkak te voneses se vleresimit ka skaduar validiteti dhe ne si OE e kemi sjellur menjihere certifikaten ne fjale me daten e skadimit, dhe ju si AK pa asnje baze ligjore na keni eliminuar me arsyetimin se e kemi derguar certifikaten nga nje trup tjetër certifikuese.

Shtrohet pyetja, A jane te njejta trupat certifikuese dhe a e kane rolin e njejte?

Automatikisht është e lehtë të kuptohet se nuk ka asnjë problem sa me të vogël të bëhet eliminimi i tyre për shkak se trupat certifikuesë janë organe kompetente për Certifikatat ISO 9001:2015 dhe të njëjtit i kanë verifikuar kushtet e kompanisë dhe aktivitetin të tyre i kanë bërë të gjitha analizat dhe pas verifikimit të tyre ndaj kompanisë sone e kanë lëshuar Certifikatën ISO 9001:2015 dhe po të njëjten certifikatë e kemi dërguar të ju si AK me letren standarde dhe ju si AK duke mos e marrë parasysh na keni eliminuar padrejtësisht. Ateherë me këtë kërkesë për rishqyrtim kërkojmë që të kthehet lenda në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të korrigjoni lëshimet që i keni bërë pasi që jemi OE i përgjegjshëm me cmim me të lirë sipas kriterëve të FDT-se dhe NJK-se.

Pra, jemi i përgjegjshëm sipas nenit 59.4 të LPP-se, pasi që i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kriteri në DT ka qenë si më poshtë:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 për servisimin e paisjeve Stomatologjike.

Dëshmia 2. Certifikata ISO 9001 2015 për OE - Kopje.

Pra siç vrehet nuk qenë e potencuar ISO 9001 2015 e cekur valide apo diçka të tillë pra vetëm "Dëshmia 2. Certifikata ISO 9001 2015 për OE – Kopje" edhe pse në ISO janë ka qenë Valide gjatë ofertimit dhe gjatë vlerësimit kemi dorëzuar ISO valide "Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 për servisimin e paisjeve Stomatologjike" sa i përket arsytimit tuaj si më poshtë:

Te dy ISO Certifikatat e dorëzuara nga OE PRO MEDICAL SH.P.K të lëshuar nga; LMS Certification Limited dhe MANAGEMENT SYSTEM CERTIFICATE konsiderohet të pa pranueshme pasi që nuk përfshinë laraminë e certifikimit siç edhe është kërkuar në kriterin e lartcekur, ku është specifikuar qartë certifikuar me ISO 9001 2015 për servisimin e paisjeve Stomatologjike.

Citim" nuk përfshinë laraminë e certifikimit siç edhe është kërkuar në kriterin e lartcekur, ku është specifikuar qartë certifikuar me ISO 9001 2015 për servisimin e paisjeve Stomatologjike"

Në ju informojmë se ISO e jonë në anglisht: This certificate is valid following services (shqip. Kjo certifikatë është e vlefshme në vijim të shërbimeve) është ang. "Trade, installation, maintenance and technical assistance of medical equipment, medical equipment, electronic and electrical support. Wholesale and retail trade and distribution for state and private entities of consumer materials for medical and sanitary use, equipment and protective

materials for medical / sanitary personnel, medicines and various pharmaceutical and parapharmaceutical accessories, raw materials and pharmaceutical products in pharmacies, private and state hospitals, medical laboratories and dental clinics” ose shqip “Tregtim, instalim, mirëmbajtje dhe asistencë teknike të pajisjeve mjekësore, pajisjeve mjekësore, mbështetje elektronike dhe elektrike. Tregtim me shumicë dhe pakicë dhe shpërndarje për subjektet shtetërore dhe private të materialeve konsumatore për përdorim mjekësor dhe sanitar, pajisje dhe materiale mbrojtëse për personelin mjekësor/sanitar, medikamente dhe aksesore të ndryshëm farmaceutikë dhe parafarmaceutikë, lëndë të para dhe produkte farmaceutike në farmaci, spitale private dhe shtetërore. , laboratorë mjekësorë dhe klinika dentare”

Pra siç vrehet në ISO jonë në anglisht This certificate is valid following services (shqip. Kjo certifikatë është e vlefshme në vijim të shërbimeve) është cekur Medical Equipment ose shqip Pajisjet mjekësore pra ky termë përfshijnë një gamë të gjerë të pajisjeve, instrumenteve dhe aparateve që përdoren në fushën e mjekësisë për diagnostimin, trajtimin, monitorimin ose parandalimin e kushteve mjekësore. Këtu janë disa se çfarë përfshihet në pajisjet mjekësore ose Medical Equipment: Pajisje Diagnostikuese, Pajisje Terapeutike, Pajisje Monitorimi Pajisje Laboratorike, Pajisje Dentare, Pajisje Ortopedike, Pajisje për Oftalmologji etj.

Ky është vetëm një listë e pjesshme, pasi pajisjet mjekësore përfshijnë një sërë të gjerë veglash dhe teknologjish të përdorura në specialitetet mjekësore të ndryshme dhe në rrethet e ndryshme të kujdesit shëndetësor te gjitha keto jane Pajisjet mjekësore (medical equipment).

Pra siç vrehet arsytimi juaj i cekur me lart nuk qëndron sepse ne kemi me ISO per instalim, mirëmbajtje dhe asistencë teknike të pajisjeve mjekësore ose anglisht: *installation, maintenance and technical assistance of medical equipment.*

Ligji i prokurimit publik, shume qarte e sqaron se gjithë AK e kane obligim dhe pergjegjesi te kursejne buxhetin publik. Pra, ne rastin konkret eliminimi jone nga ana juaj si MSH, ka qene tendencioz dhe kjo na demton tejmase, pasi qe jemi OE qe jemi i pergjegjshem per kete aktivitet dhe ne duhet te rekomandohemi per kontrate e jo te eliminoheми.

Sqarimet tona qe ua kemi sjellur jane te bazuar ne fakte dhe prova dhe nuk ka asnje baze sa me te vogel qe qon ne anulim te aktivitetit se kinse asnjeri OE nuk eshte i pergjegjshem sipas kritereve te FDT-se dhe NJK-se.

Pra, ju si AK e keni shkel nenin 62 te LPP-se, pasi keni anuluar aktivitetin pa baze ligjore, pasi qe kjo ndikon qe te mos trajtohen njejte te gjitha OE sipas nenit 7 te LPP-se, konkretisht paragrafi 1 e sqarojne se OE duhet te trajtohen te gjitha te barabarte dhe te mos perdoren kritere diskriminues.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se thote: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Bazuar ne nenit 7 te LPP-se, AK ka qene dasht te kerkoj sqarime dhe te vertetoj sqarimet ne rast se nuk keni qene te kenaqur me sqarime tone, keni mund ti drejtoheni trupes certifikuese, e cila eshte organ kompetent qe merret me leshimin e ketyre certifikatave ISO.

Qellimi i LPP-se eshte shfrytezimi sa me racional i parase publike dhe me qarte i sqarojne dispozitat ligjore si me poshte.

Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 6 te LPP-se thote:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës

Bazuar ne keto dispozita ligjore qe AK i ka shkelur duhet te veproje ne harmoni me kriteret e FDT-se dhe pasi qe jemi me cmim me te lire te rekomandohemi per kontrate, e jo te diskriminohemi ashtu sic na ka diskriminuar ju si AK-Ministria e Shendetesise, sepse kjo ka mund shume lehte te sqarohet sepse ne kemi informuar dhe kemi dorzuar te gjitha shenimet shtese dhe ISO 9001 2015 per komisioni vlersues.

Andaj, ne si OE ankues, duke u bazuar ne provat e paraqitura si me larte, kerkojme nga Autoriteti kontraktues – MINISTRIA E SHENDETESISE qe te merret paraysh kjo kerkese per rishqyrtim dhe te merr:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar kerkesa per rishqyrtim dhe lenda te kthehet ne
- II. **RIVLERESIM**, dhe gjate fazes se rivleresimit AK te merr parasysh sqarimet tona te bazuara e qe i plotesojme te gjitha kriteret e kerkuara te FDT dhe NJK-se, dhe
- III. **SHPERBLEHEMI** me kontrate, pasi qe jemi OE i pergjegjshem me cmim me te lire sipas kritereve te dosjes se tenderit.

Dëmet materiale

Demet e pakalkuluara gjer me tani kapin vleren mbi 500.00 €

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE ankues:

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për Rishqyrtim te datës 15.08.2023 dhe ne baze te sqarimeve te ofruara dhe dokumentacionit te lendes, pajtohemi me pretendimet e juaja, shfuqizohet Njoftimi mbi Vendimin e AK i publikuar me datën 11.08.2023 dhe lënda kthehet ne rivlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Pro Medical SHPK
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit